

Politika e asistencës financiare

CoxHealth dëshiron të ndihmojë pacientët të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor ose të cilët kanë nevojë për ndihmë të paguajnë faturat e spitalit. Si organizatë jofitimprurëse për kujdes shëndetësor, CoxHealth kujdeset për pacientët tanë dhe komunitetet të cilave iu shërbejmë nëpërmjet shëndetit më të mirë dhe kujdesit shëndetësor më të mirë. Stafi ynë mund t'ju ndihmojë në rastet e dhëna në vijim:

- Aplikoni për sigurim shëndetësor nëpërmjet Marketplace
- Aplikoni për asistencë nga Medicaid ose për aftësi të kufizuara
- Përcaktoni nëse jeni i kualifikuar për asistencë financiare nga CoxHealth

Asistencë financiare nga CoxHealth

Së pari dhe më kryesorja, rrethanat tuaja financiare nuk do të ndikojnë në kujdesin tuaj. Të gjithë pacientët trajtohen me respekt dhe drejtësi. Pacientët që plotësojnë kushtet e caktuara të ndërlidhura me të ardhurat e tyre, mund të kualifikohen për asistencë financiare nga CoxHealth, duke përfshirë pagesa të reduktuara në spital dhe plane të pagesave.

Sipas **Lista 1**, të bashkëngjitur, pacientët të cilët kualifikohen për asistencë financiare do të faturohen jo më shumë se shuma e zakonshme e faturuar për individët që kanë sigurim i cili mbulon një kujdes të tillë. Informacioni në lidhje me shumat e zakonshme të faturuara dhe llogaritja e tyre është në dispozicion në **Lista 1**, të bashkëngjitur, duke folur me një këshilltar financiar ose duke telefonuar numrat e mëposhtëm.

Aprovimi i asistencës financiare do të jetë në fuqi për 6 muaj nga data e aprovimit. Përjashtimet

nga kriteret kualifikuese për asistencë financiare do të merren parasysh në mënyrë individuale.

Kualifikimet mjekësore për asistencë financiare

CoxHealth do të ofrojë, pa përjashtim, kujdesin për rastet mjekësore emergjente për të gjithë pacientët që kërkojnë kujdes të tillë, pavarësisht nga mundësia për ta paguar ose për t'u kualifikuar për asistencë financiare, në pajtim me kërkesat e Ligjit për trajtim mjekësor emergjent dhe punë aktive (EMTALA).

Asistenca financiare është në dispozicion vetëm për emergjencë dhe shërbime të domosdoshme mjekësore. Kjo nuk vlen për procedura jo të detyrueshme siç është kirurgjia kozmetike. Kjo gjithashtu nuk vlen për pjesën e shërbimeve tuaja që janë paguar nga një palë e tretë, siç janë kompania e sigurimeve ose programi qeveritar.

Kushtet e të ardhurave për asistencë financiare

Shuma e asistencës financiare që merrni është e bazuar në informacionin e nivelit federal të varfërisë të caktuar çdo vit nga qeveria e SHBA. Të ardhurat nga asistenca financiare dhe programi i zbritjes që tregon këto nivele të të ardhurave janë të bashkëngjitur te **Lista 2**. Përveç të ardhurave tuaja, në zbritje gjithashtu do të merret parasysh madhësia e familjes suaj.

Lista e ofruesve të shërbimeve të përfshirë në këtë politikë është e bashkëngjitur si **Lista 3**. Shërbimet e tjera të faturuara veçmas nga ofruesit e tjerë, siç janë mjekët e pavarur, nuk janë të pranueshëm sipas politikës për asistencë financiare të CoxHealth. Ju lutemi shikoni **Lista 4**, të bashkëngjitur, për të parë listën e plotë të këtyre ofruesve të shërbimeve. Këto lista janë

gjithashtu në dispozicion duke përdorur informacionin e mëposhtëm.

Aplikimi për asistencë financiare

Ju mund të aplikoni për asistencë financiare në çdo kohë - para, gjatë ose pas kujdesit tuaj, deri në 240 ditë pas faturës tuaj fillestare. Bashkë me faturën tuaj ne do të dërgojmë informacionet rreth mënyrës së aplikimit për asistencë. Një aplikim gjithashtu është në dispozicion te **Lista 5** bashkëngjitur, sipas kërkesës tek ambientet e CoxHealth, duke përfshirë, por jo kufizuar në, dhomat e emergjencës dhe zonat e pranimit, ose duke telefonuar numrat më poshtë dhe duke kërkuar një kopje. Aplikimi kërkon dëshmi për të ardhurat siç është dokumenti për tatimin mbi të ardhurat ose çeku i rrogës. Shembuj të dokumenteve që mund të përdoren si provë për të ardhurat mund të gjenden në formularin e aplikimit.

Pacientët të cilët nuk janë të siguarur ose janë të pranueshëm/të regjistruar në Medicaid, automatikisht kualifikohen për asistencë financiare për shërbime emergjente dhe shërbime spitalore të domosdoshme mjekësore që nuk mbulohen nga Medicaid. Pacientët gjithashtu mund të aprovohen për asistencë financiare shtesë duke u bazuar në pozicionin financiar dhe/ose social-ekonomik të pacientit. Të qenët i pranueshëm për këtë lloj asistence nuk e kualifikon automatikisht pacientin për asistencë në të ardhmen.

Aplikimet e plotësuara mund të dorëzohen në spital personalisht, me postë ose faks në:

CoxHealth

Attn: Financial Counselors
1423 N. Jefferson Ave.
Springfield, MO 65802
Faks 417-269-0518

CoxHealth Branson

Attn: Financial Counselors
P O Box 650
Branson, MO 65615
Faks 417-335-7071

CoxHealth Monett

Attn: Financial Counselors
801 N. Lincoln Ave.
Monett, MO 65708
Faks 417-354-1185

Cox Barton County Hospital

Attn: Resource Coordinator
29 NW 1st Lane
Lamar, MO 64759
Faks: 417-681-5266

ose nëpërmjet postës elektronike:

FinancialAssistanceApplications@CoxHealth.com

Sa do të zgjasë kjo?

Ju duhet të merrni një përgjigje brenda 10 – 15 ditëve të punës nga koha e përfundimit të aplikimit tuaj. Për t'u siguruar që aplikimi juaj të përpunohet sa më shpejt që është e mundur, është shumë e rëndësishme që ne të pranojmë të gjitha dokumentet e kërkuara. Shihni aplikimin tonë për më shumë informacion.

Çfarë të bëj për faturën time ndërkohë që pres?

Ju duhet të bëni një marrëveshje për pagesë me CoxHealth gjatë procesit të aplikimit.

Arkëtimi

Nëse jeni përgjegjës për bilancin e mbetur pas aprovimit të asistencës financiare, CoxHealth do të punojë me ju lidhur me marrëveshjen për pagesë. Nëse këto pagesa nuk janë bërë dhe ju nuk na kontaktoni, ne mund të përdorim shërbimet e një agjencie të palës së tretë për t'u marrë me ju lidhur me arkëtimin e pagesës. Kuptojeni se çfarë do të thotë kjo për ju, duke shqyrtuar politikën arkëtuese të CoxHealth, të bashkëngjitur si **Lista 6**.

Mësoni më shumë

Për më shumë informacion rreth asistencës financiare nga CoxHealth, marrjes së aplikimit, ose kërkesës për pranim me shkrim të njoftimit ose komunikimit në mënyrë elektronike, ju mund të vizitoni njërin nga departamentet në vendndodhjet e e dhëna më poshtë ose mund të telefononi në njërin nga numrat në vijim për të folur me një këshilltar financiar. Këshilltarët financiarë të CoxHealth janë në dispozicion për t'ju ndihmuar të plotësoni aplikimin ose t'iu përgjigjen pyetjeve që mund të keni në lidhje me politikën për asistencë financiare të CoxHealth:

Qendrat mjekësore të Cox (Cox South dhe Cox North):

Emergency or Admissions Departments
3801 S. National Ave.
Springfield, MO 65807
417-269-0523

Meyer Orthopedic and Rehabilitation Hospital

Admissions Department
3535 S. National Ave.
Springfield, MO 65807
417-269-9800

Cox Medical Center Branson:

Emergency or Admissions Departments
525 Branson Landing Blvd,

Branson, MO 65616
417-348-8930

Cox Monett Hospital:

Emergency or Admissions Departments
801 N Lincoln Ave.
Monett, Mo 65708
417-354-1118

Cox Barton County Hospital

Emergency or Admissions Departments
29 NW 1st Lane
Lamar, MO 64759
417-681-5100

Informacion shtesë dhe formularët për aplikim mund t'i gjeni në internet në këtë adresë:

www.coxhealth.com.

Njoftim

Në përpjekje për të informuar pacientët, familjet dhe komunitetet tona për politikën e asistencës financiare të CoxHealth, kemi ndërmarrë hapa për të publikuar gjerësisht këtë politikë duke postuar shenja në zonat e pranimit dhe regjistrimit, duke përfshirë departamentet e emergjencave dhe duke shpërndarë informacion në klinikat e mjekëve dhe në vende të tjera publike me anë të postës. Përveç kësaj, politika për asistencë financiare, e cila gjithashtu është një përmbledhje e thjeshtë gjuhësore, dhe aplikimi për të, janë në dispozicion në gjuhën angleze, spanjolle, birmane, suahile, vietnameze, shqipe, ruse, rumune, portugeze, polake, karene, kineze, hmonge, marshalleze dhe mandarine.

Në fuqi më 11/2018